



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 958 Prot.

Gjirokastrë, më: 7 / 06 / 2024.

VENDIM
Nr. 11. Dt. 7. 06. 2024

Bazuar në nenin 6, pika 2, gërma d, si dhe nenit 10 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë", KIZ

VENDOSI

- Të miratojë dokumentacionin për akreditimin e vëzhguesve të cilët do të ndjekin procesin zgjedhor, si më poshtë:
 - Dokument identifikues (*kartë identiteti/ pasaportë biometrike*) një fotokopje e të cilit do të ruhet në KIZ;
 - Vërtetim nga Zyra e Personelit të Universitetit "Eqrem Çabej" për trupën akademike ose sekretaritë mësimore përkatëse për studentët, në të cilin të vërtetohet se është anëtar i trupës zgjedhore të universitetit;
 - Kërkesa e kandidatit për autoritet drejtues, në të cilin autorizohet personi përfaqësues;
 - Në rastin kur vëzhguesi vjen nga jashtë Univeritetit, ai duhet të paraqesë pranë KIZ autorizimin zyrtar të institucionit të interesuar.
- Personat e akredituar në cilësinë e vëzhguesit kanë të drejtë që të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Ata janë të detyruar të zbatojnë rigorozisht të gjitha detyrimet që janë të parashikuara në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë" dhe vendimet e KIZ.

KRYETARI
(Emër Mbiemër Firma)



ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Bitila Zhuli

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Dhori Terpo

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Avdul Alikaj

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Bleta Korre